



Datë: 16.05.2024

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo Qeveritare në Komunën e Fushë-Kosovës.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës u bënë thirrje të gjitha organizatave jo qeveritare të Regjistruara në divizionin e OJQ-ve që veprimtarit e tyre i zhvillojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për fazën e II-të 2024.

1. Organizatave Jo Qeveritare në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte që do të kontribuojnë në organizimin e aktiviteteve sportive.
2. Organizatat Jo Qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje .
3. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një muaj dhe maksimumi 5 muaj. Organizatat Jo qeveritare duhet po ashtu të kenë të kryer transaksionet financiare sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
4. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë Organizatat Jo Qeveritare, që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Jo Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim, që do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare në web-faqen e komunës linku www.komunaefushekosoves-rks.org , ndërsa thirrjet për sqarime dhe çështje tjera që lidhen me aplikimin mund të bëhen vetëm në mënyrën elektronike në e-mail adresën agron.breznica@rks-gov.net , jo më vonë se tetë (3) ditë pune para mbylljes së thirrjes publike.

Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është prej data: 16.05.2024 dhe përfundon me datën: 24.05.2024

Vërejtje: Organizatat Jo Qeveritare, përfitues të mbështetjes financiare, obligohen të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar me dëshminë e faturave të rregullta me

kupon fiskal, dëshmitë e pagesave të pagave dhe kontributeve, 15 ditë pas përfundimit të projektit.

Sqarim: OJQ-të, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprahe nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Fushë Kosovës në këtë thirrje

Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike:

Për OJQ:

- Formulari i projekt-propozimit (për aplikacionin online)
- Formulari i propozim buxhetit (për aplikacionin online)
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së (e skanuar në formatin PDF)
- Kopja e certifikatës së numrit fiskal (e skanuar në formatin PDF)
- Konfirmimi dhe pasqyra e llogarisë bankare së paku 1 vit (e skanuar në formatin PDF- nuk pranohet kopja e kartelës bankare)
- Vërtetimi i Administratës Tatimore.

Sqarim shitesë : Të gjitha dokumentet e cekura më lartë duhet të jenë në dy kopje fizike. Aplikacionet mund të dorëzohen në Zyrën Pritëse, si dhe me anë të postës, në adresën:

Fushë Kosovë, 12000, Rr. Tahir Zemaj, objekti i Komunës, departamenti i DKRS-së

Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen. Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në zarfin e mbyllur gjithashtu në USB e cila duhet të jetë brenda zarfit.

Formularët duhet të plotësohen me anë të kompjuterit.

Ana e jashtme e zarfit duhet ta përmbaj:

- Emrin e thirrjes publike,
- Emrin dhe adresën e plotë të aplikuesit
- Emrin e plotë të projektit
- Mbishkrimin "Mos e hap para hapjes zyrtare".

